**AKTI I THEMELIMIT**
**TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**"TDI METROLOGY" SH.P.K**

Sot, në Elbasan, më datë 11.04.2024, ne, themeluesit,

a) **Zamir Durbaku**, atësia Ramis, shtetas Shqiptar, identifikuar me anë të Kartes se Identitetit numër personal identifikimi **I30307084F** i datëlindjes **07/03/1983**, lindur në Prrenjas dhe banues në Elbasan; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
b) **Turkeri Demirkol**, atësia Levent, shtetas Turk, identifikuar me anë të pasaportës numër personal identifikimi **U31234406** i datëlindjes **12/09/1998**, lindur në Tire dhe banues në Elbasan; Shqiperi madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
c) **Irena Bajraktari**, atësia Abasali, shtetase Shqiptare, identifikuar me anë të Kartes se Identitetit numër personal identifikimi **I55327040O** i datëlindjes **27/03/1985**, lindur në Elbasan dhe banuese në Elbasan madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1**
**Themelimi**

**1)** Emri i shoqërisë është **"TDI METROLOGY" shpk**
2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:**
**Objekti**

1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
   a) Laborator Kalibrues Instrumentash Mates Peshimi, në përputhje me standardin SSH EN ISO/IEC 17025:2017.
   b) Laborator Kalibrues i gramareve Standard, të Klasave të ndryshme, me pasiguri sipas Rekomandimit OIML R111-2004, në përputhje me standardin SSH EN ISO/IEC 17025:2017.
   c) Tregetim Instrumentash Mates Peshimi, te precizionit te larte dhe gramare peshimi te te gjitha kapaciteteve dhe klasave.
   d) Trajnim personeli, në përputhje me standardin SSH EN ISO/IEC 17025:2017.

**Neni 3:**
**Kohëzgjatja**

1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:**
**Selia**

1) Shoqëria e ka selinë në: Lagjja Çlirimi, rruga Zogu i Pare, zona kadastrale 8522, pasuria nr.10/160-N, Elbasan.
2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5**
**Kapitali themeltar**

1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 2,000,000 (pesëqind mijë) Lekë dhe është i ndarë në 3 (tre) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
   a) Ortaku themelues Zamir Durbaku, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme (teteqind mije) Lekë, që përben 40 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
   b) Ortaku themelues Turkeri Demirkol, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme (gjashteqind mije) Lekë, që përben 30 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
   c) Ortaku themelues Irena Bajraktari, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme (gjashteqind mije) Lekë, që përben 30 % të kapitalit themeltar të shoqërisë
2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6**
**Administratori**

1) Administratori i shoqërisë emërohet Irena Bajraktari, atësia Abasali shtetase Shqiptare, identifikuar me numër personal identifikimi I55327040O i datëlindjes 27/03/1985, lindur në Elbasan dhe banuese në Elbasan, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

NOTER ELBASAN

**Neni 7**
**Baza Ligjore**

1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 8**
**Mosmarrëveshjet**

1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**O R T A K Ë T**
**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**"TDI METROLOGY" shpk**

Zamir Durbaku

(Emer, Mbiemer, Nenshkrim)

Türkeri Demirkol

(Emer, Mbiemer, Nenshkrim)

Denata Kongoli

Irena Bajraktari

(Emer, Mbiemer, Nenshkrim)

PERKTHYESE
DENATA KONGOLI
Nipt. L53101201E
ELBASAN - ALBANIA

V2024010740087561552

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE DURRËS**
**NOTER FATMIR Y. KOSENI**

**DATE 12/04/2024**
**NR REP 2010**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 12-04-2024, para meje Noter FATMIR Y.T. KOSENI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Elbasan, AQIF PASHA/NR.4, 28 NENTORI, NR.6/307, u paraqit personalisht:

**DEKLARUESIT**: **Zamir Durbaku,** atësia Ramis, banues në ELBASAN, lindur më 07/03/1983, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032569697 dhe nr. personal I30307084F.

**Turkeri Demirkol**, atësia Levent, shtetas Turk, lindur në Turqi dhe banues në Turqi, lindur më 12/09/1998, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me pashaporte nr. personal U31234406.

**Irena Bajraktari,** atësia Abasali, banues në Elbasan, lindur më 27/03/1985, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 038712330 dhe nr. personal I55327040O .

**Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe pranuan qe kane nenshkruar Akt Themelimin dhe Statutin e Shoqates me Pergjegjesi te Kufizuar "TDI METROLOGY" SH.P.K më datë 11.04.2024 bashkëlidhur.**

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**
FATMIR Y.T. KOSENI

Fatmir Koseni

Firmosur elektronikisht nga NISA me certifikaten :Fatmir Koseni
Data: 2024.04.12 12:54:25+02:00